


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA RAJONALE E  
NOTEREVE  
TIRANE



N<sup>o</sup>. 35 Rep.

N<sup>o</sup>. 12/1 Kol.

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k."**

Ne vitin 2020 me daten 24 SHKURT perpara meje noteres publike Gelande SHKURTAJ, anetare e Dhomes Rajonale se Noterise Tirane, u paraqit personalisht:

**Znj.Daniela KAPLLANI**, atesia Xhemal, e datelindjes 13.12.1980, e lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga "Sabaudin Gabrani 2/1", shtetsa shqiptare, me profesion ekonomiste, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e paraqitur personalisht dhe e pajisur me letërnjoftimin shqiptare me numër 029011615 dhe me numër personal I06213038P;-----

**Z.Saverio IANDIORIO**, i biri i Guido-s, i datelindjes 09.01.1952, i lindur ne Avellino (Itali) dhe po aty banues në rrugen "Contrada Caselle N.6/D P.1" (Itali), i pajisur me leternjoftimin italian me numër CA59209FY, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;-----

Zoteria i paraqitur ketu, eshte qytetar italian i cili kupton shume pak gjuhen shqipe. Per kete arsye une noterja e siperpermendur, duke vepruar edhe ne cilesine e perkthyeses zyrtare te kombinimit gjuhesor shqip-italish-shqip e njohur nga Ministria e Drejtesise se Shqiperise, deklaroj nen pergjegjesine personale se kam perkthyer verbalisht te gjithë dokumentacionin meposhtem, dhe se zoteria i siper permendur, me nenshkrimin e ketij akti, kontekstualisht ka kuptuar dhe pranuar çdo gje qe ka nenshkruar ne kete akt.;-----

Zoterinjtëe paraqitur këtu, për identitetin e të cilëve unë noterja jam e qartë, më kërkojnë nëpërmjet këtij akti publik që të konstatoj si më poshtë vijon:

**NENI 1**

**THEMELIMI DHE EMËRTIMI**

U krijua nga personate paraqitur me siper Znj.Daniela KAPLLANI dhe Z.Saverio IANDIRIO, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k."

**NENI 2**

**SELIA LIGJORE**

2.1.Shoqeria do te kete seline ligjore ne Tiranë, aktualisht ne adresen "**Rruga e Kavajes, Qendra e Biznesit, Pallati 13 katesh-Godina Raiffeisen Bank Qendrore, shk.6, ap.15, Tirane, kodi postar 1001**".Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte këtij shteti;-----

2.2.Me vendim te ortakeve, shoqeria mund te krijoje dhe anulloje (ne rast se jane çelur) seli, filiale, agjenci, perfaqesi dhe pjesmarrje, si ne qytete te tjera te Shqiperise, ashtu edhe jashte saj;-----

2.3.Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje e tille e parashikon dhe e lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme;-----

**NENI 3**

**OBJEKTI SOCIAL**

Shoqeria eshte krijuar per te kryer aktivitetet e meposhteme te cilat jane ojese perberese e objektit social:

- *Ndërtimin e ndërtesave të reja;*
- *Rikonstruktim të ndërtesave ekzistuese;*
- *Shërbime tele-marketing;*
- *Aktivitet shit-blerje pasuri të paluajjtëshme;*

**NENI 4**

**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

4.1.Koha e zgjatjes se shoqerise eshte percaktuar deri me daten 1, muaj mars dhe viti 2025;-----



4.2.Ne ndryshim, pervec rasteve te parashikuara ne ligj, ne mbarim te afatit Shoqeria do te konsiderohet e mbyllur.'-----

4.3.Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe statutin e saj.;-----

**NENI 5**

**KAPITALI SOCIAL**

5.1.Kapitali social eshte vendosur ne 100.000,00 ALL (njqind mije leke shqiptare) Leke dhe eshte i perbere nga 2 (dy) kuota sikurse eshte parashikuar me ligj. Kuota qe i perket ortakut ka pjesmarrjen si më poshtë:



Znj. Daniela KAPLLANI, ka ne posedim 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 40.000,00 ALL (dyzetë mijë lekë) të barabartë me 40% pjesëmarrje në kapitalin social.;-----

Z.Saverio IANDIORIO, ka ne pronësi 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 60.000,00 ALL (gjashtëdhjetë mijë lekë) të barabarte me 60% pjesëmarrje në kapitalin social.;-----

5.2.Pjeset e kapitalit jane te trasferueshme ne perputhje me dispozitat e kodit tregtar ne fuqi.;-----

5.3.Shitja e pjeseve te kapitalit i nenshtrohet te drejtes se parablerjes se ortakeve te tjere ne perputhje me statin e kesaj shoqerie, ne proporcion me pjeset e kapitalizuara dhe te zoteruara prej tyre;-----

5.4.Ortaku mund te shese kuotat e tij personave te trete ne perputhje me dispozitat ligjore te kodit tregtar ne fuqi, dhe ne perputhje me parashikimet e ketij statuti;-----

5.5.Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike dhe financiare te shoqerise si dhe me investime personale te ortakeve konform ligjeve ne fuqi dhe ketij statuti;-----

5.6.Ortaket kane te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tejeter te fituar ne rruge te ligjshem. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.;-----

3

#### **NENI 6**

##### **ADMINISTRIMI DHE PERFAQESIMI**

6.1.Administrimi i shoqerise do t'i besohet dhe do të kryhet nga njëri prej ortakëve të saj, Z.Saverio IANDIORIO;-----

6.2.Administratori i ka te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me ate çfare parashikon ligji, akti i themelimit dhe statuti.;-----

6.3.Administratori i ka te gjitha kompetencat per kryerjen e te gjitha akteve qe ai do t'i konsideroje si te dobishme per permbushjen e objektit social;-----



6.4.Administratori perfaqeson shoqerine ne raportet me te tretet, prane organeve te adminitrates publike dhe atyre gjyqesore;-----

#### **NENI 7**

##### **VITI USHTRIMOR**

7.1.Viti ushtrimor mbyllet me daten 31 dhjetor te çdo viti. Viti ushtrimor i pare do te mbyllet me 31 Dhjetor 2020; Ne perfundim te çdo viti ushtrimor organi administrativ do te merret me redaktimin e bilancit ushtrimor, ne perputhje me afatet dhe dispozitat ligjore;-----

7.2.Bilanci mund t'ju prezantohet ortakeve per aprovim brenda njeqind e tetedhjete diteve nga data e mbylljes se vitit ushtrimor;-----



7.3. Dokumentet kontabel, te shoqeruara ne rast se eshte parashikuar, edhe me relacionin e ekspertit kontabel te autorizuar, duhet qe t'i komunikohet edhe ortakeve dhe t'iu vihet ne dispozicion prane selisnie ligjore te shoqerise te pakten 30 dite nga data e mbledhjes se asamblese;-----

**NENI 8**

**LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM**

8.1.1 Per gjithçka qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete akt, i drejtohet dispozitave ligjore shqiptare ne fuqi ne kete lende, dhe me konkretisht Ligjit n.9901 i dates 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ";-----

**NENI 9**

**SHPENZIMET E AKTIT TE THEMELIMIT**

9.1. Shpenzimet dhe taksat e ketij akti, sidhe akte te tjera te bashkelidhura apo te derivuara, jane ne ngarkim te shoqerise qe po krijohet;-----

**NENI 10**

**ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE GJYQESORE**

10.1. Konfliktet gjyqesore qe do te mund te lindnin midis ortakeve apo midis ortakeve dhe shoqerise dhe qe kane per objekt te drejta konkrete qe kane te bejne me raportet e tyre me shoqerine do te zgjidhen perpara Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane;-----

**NENI 11**

**DISPOZITAT MBYLLESE**

11.1. Ky akt themelimi i shoqerise eshte perpiluar ne kater kopje te formatit A4 te shkruara nga te dyja anet, ne gjuhen shqipe. Lexuar, aprovuar dhe nenshkruar nga ortakët.  
Autorizohet në këtë akt-themelimi, nga te dy ortakët zonja Valentina HYSA, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetase shqiptare e pajisur me leternjptimin me numer personal G35404051C, e cila do të kryejë të gjitha përbushjet administrative pranë QKR-së, me qëllim regjistrimin përfundimtar të shoqërisë në organet kompetente.;-----

**ORTAKËT THEMELUES**

**ZNJ. Daniela KAPLLANI**

*Daniela Kapllani*

**Z. Saverio IANDIORIO**

*Saverio Iandiorio*

**NOTERI PUBLIK**

*Flora Skarta*

**HYRJE**

Në përputhje me Nenin 2,3,4 dhe 6 të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Nenin 20 dhe 22 të Ligjit Nr. 9723 datë 03/05/2007 "Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe Aktit të Themelimit të Shoqërisë Tregtare "ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k".

**Znj.Daniela KAPLLANI**, atesia Xhemal, e datelindjes 13.12.1980, e lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, rruga "Sabaudin Gabrani 2/1", shtetsa shqiptare, me profesion ekonomiste, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e paraqitur personalisht dhe e pajisur me letërnjoftimin shqiptare me numër 029011615 dhe me numër personal I06213038P;-----

**Z.Saverio IANDIORIO**, i biri i Guido-s, i datelindjes 09.01.1952, i lindur ne Avellino (Itali) dhe po aty banues në rrugen "Contrada Caselle N.6/D P.1" (Itali), i pajisur me leternjoftimin italian me numër CA59209FY, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;-----

Zoteria i paraqitur ketu, eshte qytetar italian i cili kupton shume pak gjuhen shqipe. Per kete arsye une noterja e siperpermendur, duke vepruar edhe ne cilesine e perkthyeses zyrtare te kombinimit gjuhesor shqip-italish-shqip e njohur nga Ministria e Drejtesise se Shqiperise, deklaroj nen pergjegjesine personale se kam perkthyer verbalisht te gjithë dokumentacionin meposhtem, dhe se zoteria i siper permendur, me nenshkrimin e ketij akti, kontekstualisht ka kuptuar dhe pranuar çdo gje qe ka nenshkruar ne kete akt;-----

Zotërinjtëe paraqitur këtu, për identitetin e të cilëve unë noterja jam e qartë, kanë vendosur sot më datë 18 të muajit shkurt, të vitit 2020 të hartojnë Statutin e një Shoqërie me përgjegjësi juridike të kufizuar nën kushtet e mëposhtme;-----

**STATUTI**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI JURIDIKE TË KUFIZUAR**

**"ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k."**

**FORMA LIGJORE - SH.P.K.**

**KAPITALI THEMELTAR**

**100.000,00 LEKË**


**SELIA:**

**ADRESA: "Rruga e Kavajes, Qendra e Biznesit, Pallati 13 katësh-Godina Raiffeisen Bank Qendrore, shk.6, ap.15" kodi postar 1001**

**TIRANË (SHQIPËRI)**

**KREU I**

**FORMA, EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**



**NENI 1**

**FORMA LIGJORE E SHOQËRISË TREGTARE**

1.1.Themelohet një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos, por jo vetëm, me ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr. 9723 datë 03/05/2007 "Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", akteve ligjore që do të jenë në fuqi përgjatë kohës së aktivitetit të Shoqërisë, si dhe me Aktin e Themelimit që i bashkëlidhet këtij Statuti.;-----

**NENI 2**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

2.1.Emërtimi tregtar i Shoqërisë është "ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k". Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga Shoqëria, emërtimi i saj do të ndiqet nga emertimi i percaktuar si me siper "ENDEA&ENGINEERING Sh.p.k", nga tregimi i kapitalit themeltar, të NUIS-së dhe nga adresa e selisë.;-----

**NENI 3**

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

3.1.Objekti i aktivitetit ekonomik dhe financiar të shoqërisë "ENDEA&ENGINEERING sh.p.k." do të jetë:

- *Ndërtimin e ndërtesave të reja;*
- *Rikonstruktim të ndërtesave ekzistuese;*
- *Shërbime tele-marketing;*
- *Aktivitet shit-blerje pasuri të paluajftëshme;*

**NENI 4**

**SELIA E SHOQËRISË**

4.1.Selia ligjore e Shoqërisë është në adresën vijuese: rruga "Rruga e Kavajes, Qendra e Biznesit, Pallati 13 katesh-Godina Raiffeisen Bank Qendrore, shk.6, ap.15, Tirane, kodi postar 1001 Shqipëri;-----



4.2.Selia mund të transferohet përkohësisht në çfarëdo ambienti tjetër të komunës së Tiranës, në një komunë tjetër kufitare, ose kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Ortakëve;-----

4.3.Në rast të një transferimi të ardhur si pasojë e vendimit të Asamblesë së Ortakëve, Administratori ka detyrimin e bërjes së ndryshimeve përkatëse në Statutin e Shoqërisë dhe depozitimin brenda afateve ligjore të dokumenteve të ndryshuar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.;-----

**NENI 5**

**KOHËZGJATJA**

5.1.Kohëzgjatja e aktivitetit ekonomik dhe financiar të shoqërisë është parashikuar për një periudhë prej 5 (pese)



vitesh duke filluar nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri me datën 1 mars, 2025.;--  
5.2.Periudha e sipërpërmendur mund të zgjatet nëpërmjet një Vendimi të Asamblesë së Ortakëve, ose të shkurtohet në rastin e likuidimit të parakohshëm të Shoqërisë;-----

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KALIMI DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT**

#### **NENI 6**

##### **KAPITALI THEMELTAR**

6.1.Kapitali themelor i Shoqërisë është 100.000,00 Lekë (njëqind mijë lekë shqiptare), dhe është i përbërë në 2 (dy) kuota të vetme me vlerë nominale prej:

Znj.*Daniela KAPLLANI*, ka ne posedim 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 40.000,00 ALL (dyzetë mijë lekë) të barabartë me 40% pjesëmarrje në kapitalin social;-----

Z.*Saverio IANDIORIO*, ka ne pronësi 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 60.000,00 ALL (gjashtëdhjetë mijë lekë) të barabarte me 60% pjesëmarrje në kapitalin social;-----

6.2.Rritja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve në rastet kur kanë votuar ortaket që përfaqësojnë 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.Me anë të së njëjtës procedurë veprohet edhe për zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;-----

#### **NENI 7**

##### **KONTRIBUTET**

7.1.1Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i Ortakëve Themelues të Shoqërisë dhe ndahet si vijon;

*Ortaku Daniela KAPLLANI*, ka ne posedim 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 40.000,00 ALL (dyzetë mijë lekë) të barabartë me 40% pjesëmarrje në kapitalin social.;-----

*Ortaku Saverio IANDIORIO*, ka ne pronësi 1 kuote ne kapitalin social me vlere te pergjithshme 60.000,00 ALL (gjashtëdhjetë mijë lekë) të barabarte me 60% pjesëmarrje në kapitalin social;-----

7.2.Totali i kontributeve të sipërpërmendura përbën kapitalin themeltar të Shoqërisë;-----


#### **NENI 8**

##### **KALIMI DHE**

##### **TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT**

8.1.Kuotat janë lirisht të trasferueshme nëpërmjet raporteve të trashëgimisë, në rastet e ndarjes së pasurisë ndërmjet bashkëshortëve,ose ne rastete e tjera të parashikuara me ligj;--

8.2.Ortakët gjithsesi kanë të drejtën e parablezjes për çdo



shitje kuotash, të drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda një periudhe 30 ditore (tridhjetë) nga data e ofertës për shitje, të shprehur nëpërmjet një letre rekomande nga ortaku shitë;-----

### **KREU III**

#### **MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË**

##### **NENI 9**

##### **ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE VENDIMET E SAJ**

9.1.Thërritja e Asamblesë do të kryhet nga Administratori, që është z.Saverio IANDIORIO.;-----

9.2.Vendimet e Asamblesë së Ortakëve merren në përputhje me ligjin, Statutin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, dhe janë të detyrueshme për të gjithë organet e Shoqërisë.;-----

9.3.Asambleja e Ortakëve vendos për çështje të tilla si ndryshimi i Statutit, përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë, emërimi apo shkarkimi i Administratorëve, i ekspertëve kontabël të autorizuar, i likuidatorëve, përcaktimin e shpërblimit për të sipërpërmendurit, zvogëlimi apo rritja e kapitalit themeltar, pjesëtimi i kuotave apo anulimi i tyre, përfaqësimin e Shoqërisë pranë Gjykatave dhe pranë institucioneve publike në procedimet ndaj Administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar, likuiduesve, aprovimin e raporteve të administrimit dhe të kontrollit të Shoqërisë, aprovimin e bilanceve vjetore, shpërndarjen e dividendëve, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar te të tretët nëpërmjet shitjes, zgjatjen e kohës së aktivitetit ekonomik dhe financiar të Shoqërisë, likuidimin e saj, riorganizimin juridik të Shoqërisë, shndërrimin e saj në Shoqëri Anonime apo Komandite;-----

9.4.Vendimet për rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, si dhe ndryshimi i Statutit do të konsiderohen të vlefshme, vetëm nëse në mbledhje kanë marrë pjesë dhe kanë votuar në favor të vendimit, ortakët që përfaqësojnë 100 % (njëqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;-----

##### **NENI 10**

##### **ADMINISTRIMI**

10.1.Shoqëria administrohet dhe drejtohet nga Administratori i cili do të jetë ortaku i vetëm, ose jo. Administratori zgjidhet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Ortakëve. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është për 5 (pesë) vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Emërimi i Administratorit është i vlefshëm për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së detyrës, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes së parakohshme ose të shkarkimit;-----



-10.2.Administratori ushtron detyrat e tij, brenda kompetencave dhe pushteteve të parashikuara në këtë Statut. Për gjithçka



tjetër që nuk është specifikuar në Statut është kompetente Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.;---  
10.3.Raportet ndërmjet Shoqërisë dhe Administratorit, rregullohen nga një kontratë e cila specifikon periudhën e emërimit dhe pagesën. Të gjithë kushtet dhe specifikat e kësaj kontrate do të vendosen dhe aprovohen nga Asambleja e Ortakëve me anë të një vendimi. Në raport me të tretët dhe me ortakët, Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer veprimet e administrimit të zakonshëm në interes dhe për llogari të Shoqërisë, nëpërmjet veprimeve që vijnë në përputhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, përveç atyre veprimeve që me ligj dhe Statut i përkasin në mënyrë të shprehur Asamblesë së Ortakëve. Administratori është përgjegjës kundrejt Shoqërisë dhe të tretëve, si për veprime të paligjshme ashtu edhe për veprime të cilat nuk përputhen me sa është parashikuar në Statut përgjatë administrimit të tij;-----

10.4.Administratori duhet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, të zbatojë politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Ortakëve, të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të librave kontabël të Shoqërisë, të përgatisë e nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, ti paraqesë këto të fundit për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve përpara Asamblesë së Ortakëve, të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë, të kryejë të gjitha regjistrimet dhe të dërgojë të gjithë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9723 datë 03/05/2007 "Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";-----

10.5.Administratori kryen të gjithë veprimet që përbëjnë administrim të zakonshëm të shoqërisë, mund të blejë, shesë, këmbejë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, autovetura dhe makineri, të nënshkruajë për emër e llogari të Shoqërisë kredi pranë institucioneve që veprojnë në këtë fushë, të autorizojë operacione pranë institucioneve bankare në përgjithësi dhe pranë çdo zyre private ose publike. Ai mund të punësojë ose pushojë nga puna punonjës dhe nëpunës, të emërojë Drejtorë ose funksionarë administrativë të Shoqërisë, përfaqësues me prokurë duke përcaktuar edhe kufijtë e mandatit të tyre. Firma për llogari të Shoqërisë, me përjashtim të rasteve të pagesave të kryera për llogari të të tretëve për të cilat është e nevojshme edhe firma e Drejtorit Financiar, dhe përfaqësimi i saj në çdo seli administrimi duke përfshirë edhe gjykimin përpara Gjykatës së Lartë i përket Administratorit të Shoqërisë, ose



përfaqësuesve të tij të pajisur me autorizim ose prokurë për të ushtruar këtë të drejtë nga ana e vetë Administratorit;-----  
10.6.Si Administrator i vetëm i Shoqërisë, duke filluar nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit emërohet Z.Saverio IANDIORIO, i biri i Guidos, nënshtetas italian, i lindur në Avellino (Itali), më 09.01.1954 dhe po aty banues në rrugën "Contrada Caselle N.6/D P.1" (Itali), i pajisur me leternjoftimin italian me numër CA59209FY, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;-----

#### **KREU IV**

#### **VITET FINANCIARE, LLOGARITË VJETORE, DIVIDENDËD**

##### **NENI 11**

##### **VITET FINANCIARE, LLOGARITË VJETORE**

11.1.Çdo vit ushtrimor financiar fillon me 1(një) Janar dhe përfundon me 31(tridhjetë e një) Dhjetor. Përjashtimisht, ushtrimi i parë financiar përfshin periudhën nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit deri në 31 (tridhjetë e një) Dhjetor. Llogaritë vjetore të pasqyruara në bilancet vjetore, bilancet e konsoliduara, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori ose nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, miratohen nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve;-----

11.2.Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore financiare të Shoqërisë bëhet brenda një afati të caktuar prej 3 (tre) muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar;-----

##### **NENI 12**

##### **SHPERDARJE E DIVIDENDËVE**

12.1.Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, si dhe pasi të evidentohet fakti se aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të e kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajsh, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve përcakton pjesën që u takon atyre në formën e dividendëve mbi fitimin dhe/ose sa do të jetë investimi nëpërmjet rritjes së kapitalit themeltar të Shoqërisë, dhe në rast se vendoset me votën në favor të Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi, shpërndarjen e fitimit;-----



#### **KREU V**

#### **ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 13**

##### **ZGJATJA E AFATIT**

13.1.Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 (pesë) të Statutit, zgjatja e tij mund të vendoset nga Mbledhja e

Asamblesë së Ortakëve;-----

**NENI 14**

**PRISHJA**

14.1. Shoqëria priset në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij Statuti, me përjashtim të rasteve ku bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 16 ose kur ka një prishje të parakohëshme për arsyet e parashikuara me ligj. Shoqëria nuk priset kur ortakët falimentojnë, bëhen të paaftë ose vdesin;---

**NENI 15**

**LIKUIDIMI**

15.1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit me vendim të Asamblesë së Ortakëve, ose me prishjen e saj. Për kryerjen e këtij procesi Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve emërton një ose disa likuidues të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshëm të përfundimit të tyre;-----

15.2. Në fund të procesit të likuidimit Asambleja e Ortakëve vendos kontributet që i përkasin ortakut, dhe Likuiduesi u shpërndan këtij të fundit vlerën e kapitaleve të Shoqërisë të mbetura;-----

**KREU VI**

**MOSMARRËVESHJET, LEGJISLACIONI, SHPENZIMET, PËRBËRJA.**

**NENI 16**

**MOSMARRËVESHJET, LEGJISLACIONI**

16.1. Për gjithçka jo të parashikuar në këtë statut do të respektohen normat ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi të cilat rregullojnë aktivitetin e shoqërive tregtare, dhe veçanërisht sa parashikohet në Kodin Civil, ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr. 9723 dKombëtare të Regjistrimit", si dhe kur është e nevojshme normat ndërkombëtare;-----

16.2. Të gjitha kundërshtimet, gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe ortakut, lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë, i nënshtrohen gjyqimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë;-----

**NENI 17**

**SHPENZIMET**

17.1. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honorarët e paguara për Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë "ENDEA&ENGINEERINGSh.p.k." si dhe aktet që rrjedhin prej tyre i përkasin nënshkruesit të këtij Statuti deri sa Shoqëria të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;-----

17.2. Nga data e këtij regjistrimi këto shpenzime do të merren

tërësisht në ngarkim nga Shoqëria duke i përfshirë në bilancet e saj, dhe do të përdoren përpara çdo shpërndarje të fitimit, ose e shumta brenda një afati prej 1 (një) viti;-----

**NENI 18**

**PËRBËRJA**

18.1.Ky Statut përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) Nene, hartohet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë në gjuhën Shqipe, nga të cilat 1 (një) i dorëzohet ortakëve, 1 (një) mbahet nga Noteri, 1 (një) depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ku kontesktualisht me kete akt autorizohet Znj.Valentina HYSA, e lindur me 04.04.1963, ne Peshkopi dhe banuese ne Tirane, e pasjisur me leternjoftimin shqiptar me numer personal G35404051C, ndërsa 1 (një) kopje do te mbahet nga Administratori.

**ORTAKËT THEMELUES**

Znj. Daniela KAPLLANI

*Daniela Kapllani*

Z.Saverio LANDIARIO

*Saverio Landiario*

**NOTERI PUBLIK**

*Flauda Shkurtaj*